

Transformimi pronësor – privatizimi në Komunën e Gjakovës në periudhën 1990 – 1999

*Albert Baraku**

Abstrakti

Vitet e tetëdhjeta filluan me çrregullime dhe tronditje të mëdha ekonomike dhe politike në disa shtete të Bllokut të Lindjes, si rezultat i vështirësive të mëdha të grumbulluara me vite e të cilat i ka sjellë socializmi si rend shoqëror në këtë pjesë të Evropës. Fillimi ishte në Poloni dhe më vonë valët e çrregullimeve arritën edhe në ish shtetin e quajtur Jugosllavi, por përmes Kosovës. Çrregullimet nuk kishin të ndalur, ato me kohë vijuan me shtrirje edhe në të gjitha shtetet e Evropës Lindore dhe më gjerë, deri te arritja e rezultateve të para konkrete në shkatërrimin e socializmit si rend shoqëror, në fillim të viteve të nëntëdhjeta në tërë Evropën Lindore dhe vetë BRSS (Rusinë) nga edhe e kishte zanafillën.

Se vërtetë diçka duhej të ndërrohej në Bllokun e Shteteve të Lindjes, ishte më së e qartë dhe më se e nevojshme, nga se ekonomia socialiste ishte dobësuar aq shumë sa i kishte humbur edhe ato rezultate që i kishte arritur dikur dhe kështu i kishte sjellë popujt në prag të ekzistencës. Analizat e asaj kohe rreth problematikës në fjalë, çonin ndër të tjera edhe te çështja e **pronës si e pa definuar**, nga se prona ishte e shtetit ose shoqërore (në ish Jugosllavi) e jo private si në shtetet kapitaliste ku ekonomia ecte shumë më mirë dhe kishte zhvillim intensiv.

Nën veprimin e këtyre rrethanave, në ekonominë e komunës së Gjakovës, në ecje janë bërë disa transformime organizative të ndërmarrjeve duke i paraprirë më vonë **transformimit të mirëfilltë pronësor – privatizimit**.

Punimi do të hedhë dritë:

- mbi atë që vërtet ka ndodhur gjatë këtyre dhjetë viteve në ekonominë e Komunës së Gjakovës
- mbi mënyrën se si është transformuar kapitali me ligj në praktikë dhe
- nga ana tjetër, vlerësimin e rezultateve të arritura në ato rrethana të zhvillimit të afarizmit në Kosovë.

* Mr. Albert Baraku, Kolegji AAB, albertbaraku@gmail.com

Përndryshe, bazuar në të dhënat e siguruar nga ndërmarrjet e Komunës së Gjakovës, është temë që ka të bëjë me një periudhë të caktuar kohore të cilën deri me tani askush specifikisht nuk e ka trajtuar, analizuar apo vlerësuar nga ky aspekt. Nga ana tjetër është temë shumë e përfolur me vite, si para ashtu edhe pas luftës në Kosovë, në qarqet ekonomike dhe politike të vendit.

Meqenëse periudha dhjetë vjeçare 1990 - 1999 paraqet fundin e ish shtetit të Jugosllavisë dhe fillimin e konstituimit të shteteve të reja nga elementët konstituivë federativë të saj, ky punim ka rëndësi të veçantë.

Parathënie

Vitet e tetëdhjeta filluan me çrregullime dhe tronditje të mëdha ekonomike dhe politike në disa shtete të Bllokut të Lindjes, si rezultat i vështirësive të mëdha të grumbulluara me vite e të cilat i ka sjellë socializmi si rend shoqëror në këtë pjesë të Evropës. Fillimi ishte në Poloni dhe atë si reflektim i vështirësive dhe gjendjes shumë të vështirë ekonomike dhe më vonë valët e çrregullimeve arritën edhe në ish shtetin Jugosllavi, por përmes Kosovës, ku gjithashtu ishte si rezultat i vështirësive ekonomike dhe politike. Çrregullimet nuk kishin të ndalur, ato vijuan pa ndalur me shtrirje në të gjitha shtetet e Evropës Lindore dhe më gjerë, deri te arritja e rezultateve të para konkrete në shkatërrimin e socializmit si rregullim shoqëror, në fillim të viteve të nëntëdhjeta në tërë Evropën Lindore dhe vetë BRSS - Rusinë nga e kishte edhe zanafillën.

Se vërtet diçka duhej të ndërrohej në Bllokun e Shteteve të Lindjes, ishte më së e qartë dhe nga ana tjetër edhe e nevojshme, nga se ekonomia socialiste ishte dobësuar aq shumë sa i kishte humbur edhe ato rezultate që i kishte arritur dikur dhe kështu i kishte sjellë popujt në prag të ekzistencës. Analizat e asaj kohe rreth problematikës në fjalë, çonin ndër të tjera edhe te **çështja e pronës si e padefinuar** - nga se prona ishte e shtetit ose shoqërore (në ish Jugosllavi) e jo private si në shtetet kapitaliste ku ekonomia ecte shumë më mirë dhe kishte zhvillim intensiv.

Në këto rrethana, në ish shtetin Jugosllavi u emërua si kryeministër i qeverisë federative - qendrore, kroati, Ante Marković

(16.03.1989 – 20.12.1991),¹ për herë të parë që nga Lufta e Dytë Botërore në këtë post kyç emërohet një profesionalist me përvojë të suksesshme në ekonomi e jo si praktika e deri atëhershme politikan. Ai, me parullën e famshme shumë domethënëse “do të ndërtojmë një socializëm të ri”, menjëherë e filloi **procesin e njohur të transformimit pronësor**. Sipas mendimit tim, mu në atë kohë dhe nga kjo qasje e Kryeministrit për stabilizimin e situatës ekonomike në ish Jugosllavi, ishte edhe zanafilla e fillimit të shkatërrimit të ish shtetit të Jugosllavisë dhe atë nga ana e Republikës së Serbisë, sepse Serbia haptas nuk ishte e interesuar fare për procesin e transformimit pronësor e aq më pak për kalimin në rregullimin e ri shoqëror që ishte tendencë e regjionit dhe më gjerë, pra në kapitalizëm.

Çka në të vërtetë ka ndodhur në këto rrethana në ekonominë e Komunës së Gjakovës?

Periudha e studiuar në këtë punim shkencor, është përzgjedhur nga këto arsye:

- në vitin 1990 kanë filluar për herë të parë aktivitetet në ekonominë e Komunës së Gjakovës lidhur me privatizimin e mirëfilltë dhe ligjor të pronës nga ajo shoqërore në atë private,
- nga viti 1990 ka filluar “odiseja” e ndërmarrjeve ekonomike të Gjakovës, në kuptim të përballjes me shumë vështirësi nga më të ndryshmet në relacion me okupatorin e autonomisë në Kosovë, kjo përballje ka zgjatë plotë dhjetë vite, deri në shpërthimin e luftës në Kosovë me 24.03.1999 dhe
- si e kanë menaxhuar në këtë periudhë zhvillimin e afarizmit në ndërmarrjet e komunës, lidhshipi i kohës dhe cilat ishin alternativat e zbatuara.

Duke filluar nga viti 1988, kur janë bërë ndryshimet në kushtetutën e ish Jugosllavisë, realisht ka filluar rrënimi i atij shteti. Pas kësaj, më pastaj edhe Serbia bëri ndryshime në kushtetutën e vet dhe atë me pretekst të krijimit të parakushteve për legjitimimin e veprimeve që

¹ Periudha e ushtrimit të funksionit si Kryeministër.

pasuan drejt suprimimit të Autonomisë së Kosovës. Kështu me 26.06.1990, në mënyrë të njëanshme dhe antikushtetuese aprovoi ligjin për veprimin e organeve republikane në rrethana të veçanta.² E meqë Serbia në atë kohë e trajtonte gjendjen në Kosovë të rëndë dhe në rrethana të veçanta, me **05.07.1990 ia suspendoi autonominë Kosovës** dhe shpërndau dhunshëm parlamentin dhe qeverinë legjitime. Me këto veprime de-fakto dhe de jure filloi rrënimi i shtetit që quhej Jugosllavi.

Pas suspendimit të autonomisë së Kosovës, Republika e Serbisë çdo ditë vendoste masat e dhunshme në ndonjë nga ndërmarrjet e Kosovës. Të dhënat e kohës argumentojnë se masat e dhunshme nënkuptonin absolutisht vetëm largimin e të punësuarve shqiptarë nga puna dhe atë nga pozita e drejtorit e deri te punëtori më i thjeshtë. Më pastaj, udhëheqësit e emëruar në ato ndërmarrje nga pushteti okupues serb e që ishin edhe me kombësi serbe, pamëshirshëm shkatërronin atë që ishte ndërtuar me decenie nga kuadrot shqiptare kosovare. Pasuria vidhej paturpësisht ashiqare, patundshmëria shitej pa procedura ligjore dhe në ato rrethana “mjegull” përfitonin po serbët por edhe ca nga shërbëtorët që për fat të keq ishin me kombësi shqiptare! Ka shumë e shumë raste në Kosovë, ndërsa në Gjakovë janë vetëm katër raste, që në ndërmarrje fillimisht janë vendosur “masat e dhunshme” dhe më pastaj ato ndërmarrje janë integruar si pjesë të kompanive të mëdha në Serbi. Ndërmarrjet në Komunën e Gjakovës të të cilat janë vendos masat e dhunshme janë:

- në Kombinati Bujqësor Industrial “Ereniku” (pesë shoqëri aksionare brenda saj),
- në Ndërmarrjen e materialit ndërtimor “IMN”,
- në Ndërmarrjen e gomës “Elast”,
- në Fabrikën e bukës “Mulliri” në Gjakovë,
- në Stacionin e autobusëve “Kosovatrans” dhe
- në Hotel “Pashtriku”.³

² Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë, nr. 30/90.

³ Të dhënat për masat e vendosura në këto ndërmarrje janë të qëndrueshme, nga se janë siguruar nga intervista me ish drejtorët e kohës në këto ndërmarrje dhe nga dokumentacioni argumentues në arkivat e këtyre ndërmarrjeve.

Kur bëjmë një analizë të numrit të ndërmarrjeve të transformuar me ligj në Komunën e Gjakovës – që janë mbi 40 sosh, krahasuar me numrin e ndërmarrjeve në të cilat janë aplikuar masat e dhunshme nga okupatori Serb – që janë 6 sosh, mund të konkludojmë se: transformimi pronësor nga prona shoqërore në shoqëri aksionare, i bërë në ndërmarrjet e Komunës së Gjakovës, ka dhënë rezultate të konsiderueshme në ato rrethana, nga se realisht e ka penguar, pamundësuar ose e ka prelonguar në kohë, në masë të konsiderueshme vendosjen e masave të dhunshme nga okupatori serb.

Transformimin e pronës shoqërore në pronë shtetërore që e aplikonte dhe zbatonte dhunshëm Republika e Serbisë në Kosovë, ishte veprim i pa parë deri me atëherë (sui generis) i marrjes, përvetësimit ose nacionalizimit të pasurisë në mënyrë të paligjshme në Kosovë. Duhet cekur se fenomeni i pronës shoqërore ishte prezent vetëm në shtetin Jugosllav, por jo në shtetet e tjera socialiste.

Në atë periudhë, në Kosovë ishte anarki e vërtetë dhe vinte erë lufte ...! Situatë kjo e njohur mirë jo vetëm për kosovarët si vendorë, por edhe për regjionin dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Nën veprimin e këtyre rrethanave, atëherë në ekonominë e Komunës së Gjakovës, në ecje janë bërë disa transformime organizative ligjore të ndërmarrjeve duke i paraprirë më vonë **transformimit të mirëfilltë ligjor pronësor – privatizimit**, si në vijim:

- ◆ nga Organizata e Punës së Bashkuar në Ndërmarrje Shoqërore dhe
- ◆ nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar në Shoqëri Aksionare.

Pushtetarët okupues të instaluar nga Serbia në Kosovë (pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës) ishin të dhunshëm dhe për veprimet e veta mbështeteshin hapur nga policia, gjyqësori dhe ushtria e Serbisë, duke larguar masovisht të punësuarit shqiptarë nga puna nëpër ndërmarrjet kosovare.

Ja dy shembuj, në dy ndërmarrje, ku janë bërë shkelje drastike të drejtës mbi pronën private, në mesin e shumë rasteve të tjera që kanë ndodhur në Gjakovë:

Ndërmarrjes Gorenje Elektromotori sh.a. në Gjakovë i është dërguar Vendimi nr. 1971/92 me dt. 15.05.1995 nga Agjencia Republikane e Serbisë⁴ për vlerësimin e kapitalit, në të cilin e vlerëson si të pa vlefshëm transformimin pronësor që e kishte si ndërmarrje e legalizuar edhe në gjykatën e kohës. Ndërmarrja, këtë vendim jo ligjor nga struktura jo ligjore në Kosovë e kishte kundërshtuar sipas rregullativës ligjore pranë Gjykatës Supreme të Serbisë, ku edhe ishte e vetmja mundësi ligjore për ankimim në atë kohë, kuptohet mbështetur në statusin pronësor që e kishte si shoqëri aksionare. Për çudi të të gjithëve në atë kohë, nga ajo Gjykatë Supreme e Serbisë e ka marrë Aktgjykimin U.nr. 921/96 datë 28.05.1997,⁵ në të cilin transformimi pronësor është vlerësuar si ligjor dhe se Vendimi i Agjencisë Republikane të Serbisë për vlerësim të kapitalit është i pavlefshëm.

Shembulli i dytë ka të bëjë me KBI Ereniku (pesë ndërmarrje brenda saj). Kuvendi i Republikës së Serbisë në mbledhjen e vet me 21.06.1991 vendos masat e përkohshme të njohura si të dhunshme në KBI Ereniku dhe emëron Organin e përkohshëm, i cili më pastaj i drejtohet Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Gjakovë me kërkesë për regjistrimin e masave të përkohshme në regjistrin e Gjykatës. Kjo gjykatë, me Aktgjykimin nr. 233/91 dt. 05.07.1999 e refuzon këtë kërkesë me arsyetimin se bëhet fjalë për shoqëri aksionare e jo për ndërmarrje shoqërore. Por, menjëherë reagon Kuvendi i Republikës së Serbisë me vendimin tjetër nga mbledhja e dt. 29.07.1991, duke bërë korrigjimin e vendimit paraprak dhe duke e ritheksuar se ka të bëjë me shoqëritë aksionare të cekura brenda tij e jo me ndërmarrje shoqërore.⁶

⁴ Vendimi nr. 1971/92 me dt. 15.05.1995 nga Agjencia Republikane e Serbisë për vlerësimin e kapitalit.

⁵ Aktgjykimi U.nr. 921/96 me datë 28.05.1997 nga Gjykata Supreme e Serbisë. Të dy këto dokumente të lartcekura gjenden në arkivin e Ndërmarrjes Gorenje Elektromotori sh.a. në Gjakovë.

⁶ Tri dokumentet e cekur te rasti KBI Ereniku (dy vendimet dhe Aktgjykimi) gjenden të ruajtura në arkivin e kësaj ndërmarrje.

Të kuptuarit e transformimit si proces

Procesi i transformimit pronësor për shumicën e profesionistëve të asaj kohe del se ishte një gjë e re dhe e pa kuptueshme nga aspekti i aplikimit praktik. Në opinionin e kohës ky lloj transformimi ishte komentuar në dy aspekte dhe atë nga aspekti ekonomik dhe ai politik. Në këtë drejtim, në ish shtetin Jugosllavi, më e zëshmjja ishte Republika e Serbisë, e cila vlerësohte dhe frikësohej se me aplikimin e këtij lloj transformimi pronësor të përzgjedhur nga ana e Kryeministrit të ish Jugosllavisë si perspektivë e shtetit, Serbia do të humbte fuqinë e ndikimit në pronën e shtetit të vet dhe edhe atë të ish Jugosllavisë.

Në këto rrethana tejet të vështira dhe me elemente shumë kërcënuese për rendin dhe sigurinë në shtetin e asaj kohe ish Jugosllavi, ekonomia gjakovare ndër të parat, me guxim, vendosmëri, shumë profesionalizëm dhe largpamësi, ju ka qas këtij procesi pa hezitim dhe me shumë bindje, se në ato rrethana ishte mundësi për shpëtim nga masat e dhunshme dhe nga ana tjetër realisht e ardhmja e ekonomisë ishte në realizimin e tij. Përndryshe privatizimi ishte proces që ndodhte edhe në ish republikat e ish Jugosllavisë, si Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë e etj.

Duhet cekur se, që në fillim ishin paraqitur rezistenca të ashpra nga individë dhe institucione të cilat nuk e pranonin realitetin e ri dhe nuk donin ta humbnin pushtetin të cilin e mbanin me decenie. Pastaj, transformimin pronësor e vërteta nuk e pranonin as edhe strukturat udhëheqëse që erdhën pas shkatërrimit dhe rënies së pushtetit socialist dhe atë, qoftë nga mosnjohja e procesit, qoftë nga interesat për vazhdimin e avazeve të strukturave të vjetra me petkun e ri dhe kjo kishte shkaktuar huti të një pjesë e konsideruar e opinionit kosovar.

Struktura udhëheqëse e ekonomisë në komunën e Gjakovës,⁷ në këtë proces të ri të kohës e i cili jepte të kuptoje ndërrime të mëdha në

⁷ Sqarim: kush kanë qenë në atë kohë “strukturat udhëheqëse të ekonomisë në Komunën e Gjakovës”? Kanë qenë drejtorët e ndërmarrjeve të mëdha, të mbështetur fuqishëm nga stafet profesionale të tyre, pastaj e tërë klasa

kohëra që do të pasonin, shihte edhe një arsye me shumë rëndësi e ajo ishte *“marrja e forcës së argumentit mbi pronësinë dhe përgatitja për kundërvajtjet që do të pasonin në relacion me pushtetin serb”* dhe e vërteta ashtu edhe ndodhi ! Ti rikujtojmë masat e dhunshme që më vonë filloi t'i aplikojë pushteti okupues serb, me pretekst se gjoja po e mbron pronën shoqërore nga shkatërrimi dhe keqpërdorimi ! Dhe e vërteta, ato masa u pa më vonë se ishin fatale, ngase në ato ndërmarrje ku zbatoheshin, ato edhe defakto e shkatërronin përfundimisht. Kështu që ndërmarrjet e Komunës së Gjakovës përmes këtij privatizimi u përgatitën për kundërvënien të planifikuar dhe mirë koordinuar karshi masave të dhunshme që shteti i Serbisë i aplikonte atëherë në Kosovë.

Si është transformuar kapitali me ligj - në praktikë Ligji mbi ndërmarrjet

Në periudhën studimore dhjetë vjeçare (1990 - 1999), ish shteti Jugosllavi kalonte nëpër sfida të rënda, ishte Serbia ajo që pretendonte se e ka popullatën e vet nëpër të gjitha republikat dhe krahinat dhe mbështetur në këtë ajo vlerësonte se Jugosllavia ishte kryesisht Serbi. Ndërsa në anën tjetër ishin republikat dhe krahinat, kush më shumë e kush më pak të zëshme për të drejta të barabarta brenda ish Federatës ose në të kundërtën të shkohet në pavarësi të secilës. Republika e Malit të Zi, ajo e Bosnje e Hercegovinës, e Maqedonisë dhe Krahina e Vojvodinës ishin më të përmbajtura dhe jo të zëshme, nga shkaku se te ato ishte ndikimi i Republikës së Serbisë më i madh. Në këto rrethana ka ardhur si Kryeministër i Federatës Jugosllave, kroati Ante Markoviç (16.03.1989 - 20.12.1991) i cili ishte shtytës për rendin e ri shoqëror të quajtur *“socializmi i ri”*, duke iniciuar dhe realizuar bazën ligjore të nevojshme për transformim pronësor të mirëfilltë, e të cilin do e sqaroj në vijim.

punëtore e kohës dhe kuptohet edhe udhëheqja komunale fillimisht legale dhe më vonë pas masave të dhunshme të Serbisë ndaj Kosovës edhe ajo në ilegalitet. Në atë kohë Komuna e Gjakovës ka pasur mbi 20.000 të punësuar në ekonomi.

Me rastin e shqyrtimit të ligjeve që kanë të bëjnë me këtë studim, **kam konstatuar se hapja e mundësisë** për transformim pronësor dhe organizativ të pronës shoqërore është bërë me miratimin e Ligjit mbi Ndërmarrjet.⁸ Ndërsa kroati A. Markoviç ka ardhur në post si Kryeministër i Qeverisë Federale të RSFJ tek me 16.03.1989. Kjo jep për të kuptuar se edhe para ardhjes në pushtet të kroatit A. Markoviç si Kryeministër, në ish shtetin e Jugosllavisë edhe përkundër sabotimeve të mëdha që bënte Republika e Serbisë, janë miratuar ligjet që kanë paralajmëruar ndryshime të mëdha e që do të pasonin më vonë. Kjo në fakt është temë për analizë të mirëfilltë politike.

Kosova në periudhën prej 05.07.1990 – kur defakto i është suspenduar autonomia e vet e qeverisjes në ish Federatën e Jugosllavisë, dhunshëm nga Republika e Serbisë, e deri me 24.03.1999 – kur filluan bombardimet nga forcat ndërkombëtare ndaj Republikës së Serbisë, ka qenë e okupuar nga Republika e Serbisë dhe realisht në ato rrethana nuk ka mundur të miratojë ligje. Pra, bëhet fjalë për një periudhë dhjetë vjeçare nën okupim total dhe absolut. Ky fakt sqaron mjaftueshëm rrethanat nën të cilat është zhvilluar aktiviteti i ndërmarrjeve të Komunës së Gjakovës në realizimin e procesit të transformimit të kapitalit. Ky është edhe synimi kryesor i këtij studimi – për të pasqyruar realisht dhe konkretisht aktivitetin e strukturave ekonomike dhe politike të asaj kohe në Komunën e Gjakovës, të mobilizuara, të koordinuara dhe shumë të vendosura në kundërvënien aktive ndaj represionit që çdo ditë vinte duke u shtuar nga ana e okupatorit serb në Kosovë gjegjësisht në Komunën e Gjakovës. Kosova në atë kohë ishte në errësirë të vërtetë të informimit dhe çdo aktivitet sa do i vogël që arrinte të mobilizonte masat shqiptare në kundërvënien të organizuar ishte me rëndësi dhe efekt të madh për ardhmërinë e vendit – Kosovës.

Kthehemi te ana ekonomike e problemit në atë kohë. Ligjet të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kanë mundësuar transformimin pronësor e organizativ dhe privatizimin janë:

- Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90);

⁸ Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90

- Ligji për Kontabilitetin (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 64/89, 29/90),
- Ligji për Letrat me Vlerë (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 64/89, 29/90),
- Ligji për Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 84/89, 46/90),
- Ligji mbi pagesën e të ardhurave personale, të mjeteve për konsumin e drejtpërdrejtë të përbashkët dhe të mjeteve për ushqimin e punëtorëve gjatë punës (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 37/90 dhe 84/90).

Në interes të vlerësimit sa më të drejtë dhe profesional të transformimit të kapitalit – temë kjo që e ka për bazë ky studim, vlen të ceket se edhe pas luftës në Kosovë, me ardhjen e Bashkësisë Ndërkombëtare në qeverisje të përkohshme të vendit, nga qershori 1999, konkretisht nga UNMIK-u, janë vlerësuar si ligje të aplikueshme (jo diskriminuese).⁹

Zgjidhja e paraparë me Ligjin e Ndërmarrjeve¹⁰ (sipas autorëve) ishte rezultat i shumë analizave dhe konsultimeve profesionale me ekspertë të njohur botërorë të asaj kohe si dhe me institucionet monetare ndërkombëtare që pranonin ta mbështesnin . Ndërsa të gjitha këto ligje mbi transformimin e kapitalit – sipas autorëve të tyre, kishin për qëllim:

- që të ndërronin qenësisht organizimin e ndërmarrjeve ekonomike dhe atë përmes ndërrimit të statutit pronësor dmth. përcaktimin e titullarit të pronës,
- rritjen e kapitalit (dekapitalizimin) në ndërmarrjet e kohës,
- stimulimin e punëtorëve në punën e tyre në ndërmarrje,
- inkuadrimin e punëtorëve aksionarë në qeverisje të ndërmarrjeve,
- rritjen e efikasitetit ekonomik e etj.

⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59.

¹⁰ Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90)

Kjo ishte edhe arsyeja dhe argumenti kryesor që inkurajonte strukturat udhëheqëse ekonomike të kohës për aplikimin e ligjit në fjalë. Duhet pasur parasysh që ligji në fjalë nuk kishte karakter obligues por ishte i mundshëm për aplikim dhe jetësim vetëm tek ato ndërmarrje shoqërore që i kishin këto parakushte në vijim:

- që të kishin afarizëm të suksesshëm,
- të kishin afarizëm me bilanc zyrtar shumë pozitiv dhe
- nga ana tjetër të kishin vullnet dhe interes për transformim të mirëfilltë pronësor, nga prona shoqërore në atë private gjegjësisht aksionare.

Nga ana tjetër, këto ligje të transformimit të kapitalit shoqëror kishin edhe disa parime bazë në të cilat janë mbështetur, ku dy prej të cilëve sipas mendimit tim ishin më kryesorë:

- ndërmarrjet kishin autonomi të plotë për të vendosë lidhur me ardhmërinë e tyre në procesin e transformimit dhe
- ishte shumë e dukshme tendenca për favorizimin e punëtorëve, përmes motivimit material për blerjen e aksioneve dhe marrjen e ndërmarrjeve në qeverisje.

Në këtë kontekst, janë me interes edhe një mori faktorësh që duhet njohur e të cilët kanë të bëjnë me këtë ligj dhe disa nga ata si më kryesorët po i cekim në vijim:

- rrethanat shumë të vështira ekonomike si dhe shumë të komplikuar politike të kohës që kanë paraqitur nevojën për miratimin e këtij Ligji, bëhet fjalë në nivel të ish Federatës Jugosllave,
- shteti tentonte t'i pavarësojë ndërmarrjet, në mënyrë që ato të mos mbështeten në ndihma nga buxheti,
- të rritej angazhimi i klasës punëtore për të ardhmen e tyre dhe zgjedhjen e mbikëqyrjen e afarizmit të tyre,
- qëllimi që është synuar të arrihet me këtë ligj në atë federatë shikuar edhe nga aspekti politik,
- Kosova (në atë kohë me pozitë shumë specifike dhe të kërcënuar në Federatën Jugosllave) dhe ekonomia e saj si e kanë pritur këtë Ligj,
- aplikimi i këtij ligji në Kosovë dhe rezultatet e mundshme për t'u arritur,

- qasja e pushtetit serb ndaj këtij ligji,
- pasojat që i pësoi shteti i ish Jugosllavisë pas miratimit dhe fillimit të jetësimit të ligjit në fjalë,
- dhe shumë e shumë faktorë të tjerë me më pak peshë.

Njohja dhe vlerësimi profesional i këtyre faktorëve është me shumë rëndësi, nga se do të shërbente për ne sot, jo vetëm për të kuptuar brendinë e ligjit të asaj kohe, rrethanat ekonomike dhe politike në atë kohë, forma e atij transformimi pronësor, apo pozita e Kosovës në atë federatë, por edhe për marrjen e vendimeve të qëndrueshme sot, me rastin e vendosjes së rrugës më të mirë se kah duhet të shkojë ekonomia kosovare në të ardhmen.

Transformimi pronësor i ndërmarrjeve shoqërore dhe shoqatave me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare

Për ta ilustruar dhe qartësuar sa më mirë temën e studimit, do ta prezantoj në vijim procedurën ligjore të transformimit që është aplikuar në mbi 40 ndërmarrje shoqërore apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të Komunës së Gjakovës, që aktualisht kanë pasur rezultate të mira afariste dhe gjendje të mirë materiale.

Në bazë të nenit nr. 2 të Ligjit mbi afarizmin financiar,¹¹ Ligjit mbi pagesën e të ardhurave personale, mjeteve të drejtpërdrejta të konsumit të përbashkët dhe mjeteve për ushqimin e punëtorëve gjatë punës,¹² nenit nr.2 të Ligjit mbi letrat me vlerë,¹³ ndërmarrjet ekonomike shoqërore gjegjësisht shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në Komunën e Gjakovës kanë marrë:

- 1. Vendimin mbi emetimin e aksioneve interne sipas Ligjit mbi të ardhurat personale dhe**
- 2. Vendimin mbi emetimin e aksioneve interne sipas Ligjit mbi kapitalin shoqëror.**

¹¹ F.Z. RFSJ nr. 10,26,35,58 dhe 79/89

¹² (F.Z. RFSJ nr. 37/90), nenit nr. 1, 1a dhe 2 të Ligjit mbi kapitalin shoqëror (F.Z. nr. 84/89 dhe 46/90)

¹³ (F.Z. RFSJ nr. 64/89, 29/90)

Këto akte juridike kanë qartësuar në detaje procedurat e transformimit pronësor, si dhe ecurinë e zhvillimit të ndërmarrjeve të reja me status pronësor të definuar si shoqëri aksionare. Në vijim, ja disa nga sqarimet thelbësore të theksuara në këto akte juridike:

- ◆ Aksionet janë letra me vlerë të emetuar në pajtim me ligjin gjegjës.
- ◆ Aksionet janë të shprehura në valutën atëherë valide – dinar.
- ◆ Aksionet janë në emër të prurësit.
- ◆ Lejohet shitblerja e aksioneve ndërmjet aksionarëve në sh.a.
- ◆ Lejohet bartja e aksioneve në emër me indosament.
- ◆ Lejohet bartja e aksioneve në emër të prurësit me dorëzim.
- ◆ Aksionet evidentohen në sektorin financiar në evidencë të posaçme.

Shitja e aksioneve sipas të dy bazave ligjore të lartë paraqitura kuptohet se ka shkuar duke u harmonizuar dhe nuk janë lejuar shitje jo të rregullta apo jashtë procedurave ligjore, por në tërësi të kontrolluara nga sektori financiar, komisioni përgjegjës, drejtori kryesor dhe Kuvendi i aksionarëve në Ndërmarrje.

Nga materialet e siguruar për shqyrtim, del konstatimi se në Komunën e Gjakovës ndërmarrjet shoqërore që janë transformuar në këtë periudhë, kanë arritur që shumica e tyre të transformohen në masë me mbi 70 % të kapitalit shoqëror në atë privat, por ka disa raste konkrete edhe me 100 % të transformimit të kapitali nga ai shoqëror në atë privat – të aksionarëve.

Procedura e transformimit pronësor është zhvilluar edhe nën masa të rrepta kontrolluese nga ana e ish Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror, si institucion financiar me kompetenca të larta ligjore për kontroll financiare të të gjithë kapitalit dhe transaksioneve financiare në ish Jugosllavinë. Aksionet e emetuara sipas ligjit, të shoqëritë aksionare duken kështu:

Specimeni i Aksionit Intern - sipas Ligjit mbi pagesën e të ardhurave personale

(shënimet që duhet t'i përmbajë ky aksion intern)

<p>" X " sh.a.</p> <p>SERIJA No. A A 00001234</p> <p>Gjakovë</p> <p>AKSIONI INTERN</p> <p>Në vlerë</p> <p>100,00 din.</p> <p>(njëqind dinar)</p> <p>Në emër</p> <p>Aksioni intern jepet për pagesën e pjesës së të ardhurave të pastra personale në pajtim me nenin nr. 4 të Ligjit mbi pagesën e të ardhurave personale GZ e RSFJ nr. 37 / 90 dhe Vendimit të Këshillit Punëtor nr. të datës</p> <p>Aksionet nga kjo seri janë lëshuar në 1000 copë në vlerë gjithsej 100 000 din.</p> <p>Dividentat paguhet sipas Ligjit dhe Kontratës.</p> <p>Gjakovë.....</p> <p>Drejtori kryesor</p> <p>.....</p>	<p>" X " sh.a.</p> <p>Gjakovë</p> <p>KUPONI No. 1</p> <p>Për pagesën e dividendës për aksionin intern nr. i series:</p> <p>A A 00001234</p> <p>Drejtori kryesor</p> <p>.....</p>
---	--

**Specimeni i Aksionit Intern – sipas Ligjit mbi kapitalin shoqëror
(shënimet që duhet t'i përmbajë ky aksion)**

<p>“ X “ sh.a.</p> <p>SERIJA No. A B 00001234</p> <p>Gjakovë</p> <p>AKSIONI INTERN</p> <p>Në vlerë</p> <p>100,00 din.</p> <p>(njëqind dinarë)</p> <p>Në emër</p> <hr/> <p>Aksionet nga kjo seri janë lëshuar në shtypje 1000 copë në vlerë gjithsej 100 000 din. Dividenta paguhet sipas Ligjit dhe Kontratës.</p> <p>Gjakovë..... Drejtori kryesor</p>	<p>“ X “ sh.a.</p> <p>Gjakovë</p> <p>KUPONI No. 1</p> <p>Për pagesën e dividendës</p> <p>Për aksionin intern nr. i serisë A B 00001234</p> <p>Drejtori kryesor</p>
---	--

Regjistrimi dhe funksionimi i shoqërive aksionare

Ndërmarrjet shoqërore me rastin e paraqitjes së tyre në Gjykatën Ekonomike për regjistrim si shoqëri aksionare, në pajtim me Ligjin gjegjës, është deshtë që paraprakisht:

- të kenë Vendimin e Këshillit Punëtor (si organi më i lartë vendimmarrës në ndërmarrjet – shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar) për transformimin e kapitalit dhe
- të kenë shitur gjegjesisht të kenë transformuar minimumin e lejuar prej 10 % të fondit afarist sipas bilancit zyrtar.

Në të kundërtën, Gjykata Ekonomike si e autorizuar për regjistrimin e bizneseve gjegjesisht ndërmarrjeve ekonomike, nuk ua ka mundësuar regjistrimin si shoqëri aksionare.

Më pastaj në fund të vitit kalendarik, në të cilin ka filluar shitja e aksioneve, bëhej kontrollimi gjegjesisht verifikimi i kapitalit se sa

është transformuar dhe sa jo – gjë e cila shihej qartë në bilancin e gjendjes së ndërmarrjeve.

Ndërsa brenda përbrenda shoqërisë aksionare gjegjësisht aksionarëve ishte rregullativa tjetër për të drejtën e vendosjes gjegjësisht qeverisjes dhe kjo ishte e definuar në pajtim me Ligjin gjegjës, në Rregulloren e Punës së Organeve Qeverisëse.

Shoqëria aksionare në pajtim me ligjin ka pasur këto organe qeverisëse – që kanë vendos:

- Kuvendi i Aksionarëve,
- Këshilli Drejtues dhe
- Drejtori Kryesor.

Obligimet e tyre, të drejtat e tyre gjatë ushtrimit të punës, funksionimin si dhe rregullat e punës së këtyre organeve qeverisëse – vendimmarrëse i ka parapa në detaje Ligji i Transformimit. Por gjatë aplikimit dhe jetësimit në ndërmarrjet ekonomike gjakovare ka ca variacione të vogla dhe që esencën nuk kanë mundur ta ndryshojnë, por që është deshtë t’ia përshtatin madhësisë së vet fizike, numerike të punësuar, ekonomiko - financiare, organizative e të tjera.

Rezultatet e arritura, në ato rrethana të zhvillimit të afarizmit në Kosovë.

Gjatë viteve të okupimit nga ana e Serbisë, ekonomia e Kosovës e në të edhe ajo e Komunës së Gjakovës kanë kaluar nëpër vështirësi shumë të mëdha. Shprehur më saktë, kanë qenë realisht çdo ditë në tehun e mbijetesës për zhvillimin e afarizmit e deri te kërcënimet me heqje lirie dhe kërcënim me jetë të njerëzve që ishin menaxherë të ndërmarrjeve.

Në materialet e punës të bollshme që kam arritur t’i siguroj, lidhur me punën e strukturave udhëheqëse të ekonomisë në Komunën e Gjakovës të asaj kohe, shihet qartë se qëllimet e tyre kryesore për t’i arritur, kanë qenë:

- para se gjithash që ekonomia e Komunës së Gjakovës të mos mbetej pa alternativë në kundërvënie ndaj masave represive që ushtronte në vazhdimësi okupatori serb,

- thjesht ruajtja e fabrikave nga okupuesi serb, si pasuri e fituar dhe e ndërtuar me punën e punëtorëve gjatë decenieve,
- pengimi i vendosjes së masave të dhunshme dhe ruajtja e vendeve të punës si qasje e mençur në ato rrethana okupuese në të cilat ishte e tërë Kosova,
- mos lejimi i forcave okupuese serbe që të varfërojnë popullatën dhe nënshtrojnë atë,
- përcjellja e mesazhit të opinionit ndërkombëtar, se okupuesi serb po e merr me masa drastike të dhunshme shtetërore pronën private të qytetarëve të Kosovës,
- përmes mbajtjes së fabrikave në funksion ishte e mundshme dhe me shumë interes që qytetarët të koordinoheshin dhe mobilizoheshin në kundërvënien ndaj okupuesit serb,
- në ato rrethana, vlerësohej me shumë rëndësi për Kosovën, që fabrikat gjithësi të punonin duke u mbështetur në nevojën legjitime për furnizime me repromateriale si lëndë të parë dhe shitjen e produkteve finale që prodhonin fabrikat, krijohej mundësia edhe e lëvizjes së njerëzve gjë që në atë kohë ishte shumë e kufizuar dhe e kontrolluar nga okupuesi serb, por lëvizja e njerëzve nga ana tjetër mundësonte edhe informimin e opinionit të atëhershëm brenda Federatës ish Jugosllave dhe jashtë saj për atë që aktualisht ndodhte në Kosovë,
- vlen të ceket edhe kjo, se lidershipi i Komunës së Gjakovës gjatë kësaj periudhe është përpjekë që t'i nxisë edhe komunat e tjera në këtë qasje për kundërvënien të koordinuar ndaj okupatorit serb,
- dhe në fund, aktiviteti i strukturave udhëheqëse në Komunën e Gjakovës koordinohet ngushtë edhe me strukturat udhëheqëse në nivel të vendit.

Meqenëse pushteti okupues ishte arbitrar dhe nuk i respektonte as ligjet federative, në këtë rast atë të A. Markoviçit, dhe fuste masat e dhunshme në ndërmarrje pa procedurë ligjore, një pjesë e sh.a.-ve për të pamundësuar futjen e këtyre masave, kanë ndërmarrë hapin e radhës, që selinë e ndërmarrjes ta bartin jashtë Kosovës dhe atë në Republikën e Sllovenisë apo të Kroacisë. Për këtë, ato ndërmarrje e kanë tërhequr regjistrimin nga Gjykata Ekonomike e Gjakovës dhe e

kanë bartur jashtë, atje ku Serbia nuk kishte qasje ligjore për aplikimin e masave të dhunshme. Kjo ka dhënë rezultate, edhe ky aktivitet ka pamundësuar veprimin e okupatorit të disa raste.

Shprehur qartë dhe shkurt, në atë kohë interesi parësor i strukturave udhëheqëse ekonomike dhe politike në Komunën e Gjakovës ishte kundërvënia e organizuar ndaj veprimeve që bënte okupuesi serb, por nga ana tjetër ajo strukturë liderë e kohës kishte bindje se transformimi pronësor është edhe gjëja e duhur për perspektivën e vendit në të ardhmen. Në këtë drejtim, faktet flasin se janë arritur në masë të madhe synimet e caktuara.¹⁴

Sipas dokumentacionit që kam mundur ta siguroj, ndërmarrjet kryesore në Komunën e Gjakovës, të cilat në pajtim me Ligjin gjegjës janë regjistruar si shoqëri aksionare në gjykatë, ishin:

1. Holding Kompania “Emin Duraku” me brenda saj rreth shtatë ndërmarrje si subjekte të veçanta,
2. Holding Kompania “Jatex” e tekstilit me brenda saj rreth gjashtë ndërmarrje si subjekte të veçanta,
3. Kombinati Bujqësor Industrial “Ereniku” me brenda saj rreth pesë Ndërmarrje si subjekte të veçanta,
4. Holding Kompania “Metaliku” me brenda saj rreth katër ndërmarrje si subjekte të veçanta,
5. Holding Kompania “Dukagjini” me brenda saj rreth tri ndërmarrje si subjekte të veçanta,
6. Fabrika e elektromotorëve “Gorenje Elektromotori”,
7. Industria e Materialit Ndërtimor “IMN”,
8. Ndërmarrja tregtare “Agimi”,
9. Ndërmarrja servisuere për elektromotorë “Elektroservisi”,

¹⁴ Të gjitha këto të dhëna shihen qartë: në procesverbalet e takimeve të kohës, në materialet komunikuese të shumta të përgjegjësve në ndërmarrje me liderët e kohës, si dhe tani nga bisedat me kohanikët e gjallë sot, e të cilët janë të shumtë dhe aktivë sot në Komunën e Gjakovës. Në atë kohë në Komunën e Gjakovës ka funksionuar Këshilli Koordinues, e i cili ka qene bartës për menaxhimin e situatës në baza ditore, të situatës që impononte okupatori serb. Në këtë drejtim, ky organ ishte shumë autoritar për mbrojtjen e të drejtave të ndërmarrjeve në Komunën e Gjakovës, duke i organizuar, koordinuar dhe drejtuar aktivitetet e duhura.

10. Industria e drurit “Modeli”,
11. Holding kompania “Deva”,
12. Hoteleria “Pashtriku”,
13. Ndërmarrja e bukës “Mulliri”,
14. Ndërmarrja transportuese “Kosovatransi”,
15. Ndërmarrja projektuese “Ening”,
16. Ndërmarrja e përpunimit të mishit “Mishi”,
17. Ndërmarrja “Ngrohtorja e qytetit”,
18. Kooperativa bujqësore “Bec”,
19. Ndërmarrja servisuere e automjeteve “Kompresor”,
20. Ndërmarrja e përpunimit të gomës “Elasti”,
21. e të tjera.

Është arritur të sigurohen materialet e mbi 40 ndërmarrjeve të regjistruara në Gjykatën Ekonomike të Gjakovës (e cila ka qenë e autorizuar për tërë rrafshin e Dukagjinit) si shoqëri aksionare.

Në të gjitha këto ndërmarrje, marrë së bashku kanë qenë të punësuar mbi 20.000 punëtorë.

Përfundimi

Nga përvoja e shteteve të Evropës Perëndimore dhe Lindore, proceset e transformimit pronësor që i kanë zbatuar, gjegjësisht aplikuar, për asnjërin nga ato procese të transformimit të pronësisë nga prona shtetërore në atë private, nuk ka pasur vlerësime se ndonjëri nga ato ka qenë i përkryer. Por e vërteta ka pasur vlerësime se njëri ka qenë më i mirë gjegjësisht më i suksesshëm se tjetri dhe me më pak pasoja negative. Nga kjo del konstatimi logjikë se edhe për transformimin pronësor sipas Ligjit të Markoviçit nuk mundet të thuhet se ka qenë ideal dhe i përkryer, përkundër faktit se në formulimin e tij kanë qenë të kyçur shumë profesionistë të njohur ndërkombëtarë. Sidoqoftë për Kosovën ky ligj **paraqet një hap të parë dhe konkret përpara në drejtim të privatizimit** aq shumë të përfolur ndër ne dhe me aq shumë admirim të mirëpritur dhe kërkuar nga tërë ekonomia.

Në periudhën e pas Luftës në Kosovë (nga viti 1999 e këtej) këto ndërmarrje edhe më tutje janë përballuar me vështirësi të mëdha dhe nga më të ndryshmet, për të cilat ia vlen të bëhet një studim tjetër.

Bibliografia

- Janë kontaktuar dhe intervistuar personat kyç që kanë qenë bartës, përgjegjës, si lidërs dhe shumë aktivë në kohën e transformimit pronësor 1990 - 1999: Ali Buza, Fehmi Nallbani, Shaban Deva, Gazmend Tuzi, Bajram Morina, Shukri Buza, Ismajl Boshnjaku, Mahmut Rizavnofli, Abdyrrahmon Hafizademi, Avni Bytyqi, Ismet Zhaveli, Blerim Këpuska, Sherafidin Rogova e shumë të tjerë.
- Janë siguruar për shqyrtim dokumentet bazë nga arkivat e ndërmarrjeve më kryesore të transformuar që pasqyrojnë dhe argumentojnë rrjedhën në detale të transformimit pronësor. Kuptohet nga ato ndërmarrje që kanë arritur t'i ruajnë dokumentet në arkivat e tyre, nga se në disa nga ato kjo nuk është arritur, për shkak të ndryshimeve të mëdha statutare që kanë pasuar në periudhën e pas luftës në Kosovë e këtej ...!
- Më është mundësuar në Ndërmarrjen Gorenje Elektromotori sh.a. (si ndërmarrje lider e asaj kohe) që ta kem në dispozicion tërë arkivin me dokumentacionin që kanë dhe atë në mijëra faqe, që te kam mundësinë të analizoj tërë atë situatë dhe faktorët determinues të kohës.
- Studimi, Botimi i Institutit Ekonomik në Prishtinë, 2005, Statusi Juridiko - Ekonomik i shoqërive aksionare në Kosovë, me vështrim të posaçëm në Gjakovë.
- Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë, nr. 30/90.
- Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 77/88, 10, 26, 35, 40, 58,64, 79/89, 46/90 dhe 29, 61/90.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59.
- F.Z. RFSJ nr. 37/90), nenit nr. 1, 1a dhe 2 të Ligjit mbi kapitalin shoqëror (F.Z. nr. 84/89 dhe 46/90).
- Autori i këtij studimi, në atë kohë ishte njëri nga aktivistët profesional në zbatimin e privatizimit sipas ligjit në ndërmarrjet e Komunës së Gjakovës.